

## **PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Hartimi i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike"**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime për hartëzimin e zonave- 71354000-4, Projekte 22114311-5.

Vlera e Fondit Limit: **4,155,556** (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik".*

#### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

##### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika*

5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 11 të DST-së.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar..

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit....." si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën

*kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001 për “sistemin menaxhimin e cilësisë”;

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

### Argumentimi 2.3.2

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

**ISO 9001:2015** (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar të profileve si më poshtë si më poshtë:

- ✓ **1 (një) Drejtues Projekti/ekipi** (duhet të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve si dhe në këshillimin e sektorit publik).
- ✓ **1 (një) Ekspert ndryshimet klimatike** (Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në energji, inxhinieri mjedisi, Shkenca Natyrore ose të ngjashme)
- ✓ **1 (një) Ekspert institucional.**(Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në shkenca mjedisore, burime natyrore ose të ngjashme)
- ✓ **1 (një) Ekspert inventarizimi të GES.**(Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime inxhinierike, ose të ngjashme.)
- ✓ **1 (një) Ekspert për energjinë** (Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime energjetike, ose të ngjashme.)
- ✓ **1 (një) Ekspert bujqësinë dhe/ose pyjet** (Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime Agronomi, Pyje ose të ngjashme.)
- ✓ **1 (një) Ekspert për transportin dhe bujqësinë** (Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime Inxhinieri mekanike, mjedis ose të ngjashme.)
- ✓ **1 (një) Ekspert GIS dhe përpunimi i të dhënave** (Me kualifikim Master ose ekuivalent në studime inxhinierike ose të ngjashme.)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteri 2.3.3 dhe nënpikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

a) **1 (një) Drejtues Projekti/ekipi** - Drejtuesi i projektit/ekipit duhet të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve si dhe në këshillimin e sektorit publik. Diplomë Universitare në nivel Doktorant ose ekuivalent në Shkenca Natyrore, ose Shkenca Inxhinierike. Të këtë mbi 10 vjet përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin e klimës, energjisë, mjedisit, dhe menaxhimit të burimeve natyrore. Eksperiencë specifike në projekte që lidhen me klimën, mjedisin dhe energjinë në nivel lokal. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti kryesor ose menaxheri i projektit ofron udhëzime në hartimin dhe zbatimin e veprimeve specifike për të ndihmuar planin vendor të veprimit për ndryshimet klimatike. Bën rishikimin, modifikimin e të gjitha aktivitetëve të planit dhe produktet që lidhen me ndryshimet klimatike në përputhje me dokumentet e planit. Ai mundëson zhvillimin e kushteve të nevojshme për ekspertët e që do të përfshihen në hartimin e planit. Gjykohet të ketë eksperiencë pune mbi 10 vjet, për arsye se drejtuesi i projektit ka përgjegjësinë e menaxhimit të stafit të punës së projektit dhe të drejtimit teknik të aktivitetëve. Për këtë, kërkohet të ketë eksperiencë relativisht të gjatë punë pasi dhe fusha e aktivitetit është mjaft specifike. Periudha 10 vjeçare i jep mundësi që personi që do të propozohet të ketë pasur eksperiencë në drejtimin e projekteve të ngjashme dhe të ketë aftësitë e duhura menaxheriale.

Fusha e ndryshimeve klimatike ka hyrë në përjasjen e platformave dhe strategjive kombëtare këto 20 vitet e fundit dhe për këtë arsye ekspertët që kanë punuar me të duhet të kenë njohuri në zhvillimet dhe ecurinë e tyre në vëndin tonë. Kjo është një arsye që ben eksperincen 10 vjeçare të domosdoshme për të kuptuar dhe njohur kërkesat në nivel kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, që duhet të zbatohen në nivel lokal.

Gjithashtu kërkesa për të pasur njohuri dhe në zbatimin e projekteve të ngjashme që kanë lidhje me ndryshimet klimatike (ku hyn: pjesa e energjisë, klimës, natyrës, bujqësisë, transportit etj.) gjë e cila kërkon një nivel të lartë njohurish dhe që sigurisht lidhet me eksperiencën e gjatë të drejtoresit të projektit në njohuritë e ndërlydhjes së fushave të ndryshme.

**b) 1 (një) Ekspert ndryshimet klimatike** - Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent ne energji, inxhinieri mjedisi, Shkenca Natyrore ose të ngjashme. Të këtë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin e klimës, energjisë, mjedisit, si dhe eksperiencë profesionale specifike: Pjesëmarrje dhe kontribut në projekte që lidhen me analizën dhe përgatitjen e politikave dhe strategjive mbi përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti i ndryshimeve klimatike do të luajë rol në ofrimin e mbështetjes, por edhe hartimit të masave për sektorin e Energjisë, Bujqësisë, Pyjeve dhe Përdorimin e Tokës (si dhe çdo sektor tjetër që ka lidhje me ndryshimet klimatike), si dhe detyrave të tjera të cilat kërkojnë ekspertizë profesionale.

**c) 1 (një) Ekspert institucional**, - Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në shkenca mjedisore, burime natyrore ose të ngjashme. Të këtë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin e mjedisit, burimeve natyrore. Të këtë njohuri të mira mbi aspektet institucionale të funksionimit të pushtetit vendor. Të këtë përvojë në proceset e angazhimit të aktorëve dhe nxitjes së pjesëmarrjes publike në proceset e vendimmarrjes. Përvojë në përgatitjen dhe dhënien e trajnimeve për institucionet e qeverisjes vendore nëse ka, do të konsiderohet si aset pozitiv. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti institucional do të luajë rol në ofrimin e mbështetjes për sa i përket aspekteve institucionale të funksionimit të pushtetit vendor. Me njohuritë e tij rreth pushtetit vendor do të mundësojë angazhimin e palëve, aktorëve dhe grupeve e interesit në procesin e hartimit të planit.

Stafi mbështetës i kontraktorit do të ketë në përbërje ekspertë të profileve si më poshtë:

**a) 1 (një) Ekspert inventarizimi të GES** – Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime inxhinierike, ose të ngjashme. Të këtë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin në lidhje me

inventarizimin e GES. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti i inventarit GES do të kryejë inventarizimin e GES për sektorin e Energjisë, Bujqësisë, Pyjeve dhe Përdorimin e Tokës, si dhe detyrave të tjera të cilat kërkojnë ekspertizë profesionale. Ai harton propozime specifike për adresimin e çështjeve të GES dhe për treguesit që lidhen me të.

**b) 1 (një) Ekspert për energjinë** – Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime energjetike, ose të ngjashme. Të ketë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin energjisë. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti për energjinë do të trajtojë të gjitha aspektet e ndikimit të energjisë në ndryshimet klimatike, si dhe do të ofroj masa konkrete në lidhje me reduktimin e ndikimit të energjisë.

**c) 1 (një) Ekspert bujqësinë dhe/ose pyjet** – Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime Agronomi, Pyje ose të ngjashme. Të ketë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin e bujqësisë dhe pyjeve. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti për bujqësinë dhe/ose pyjet do të kontribuojë në dhënien e ekspertizës për ndikimin dhe shtimin e pyllëzimit në mënyrë që të zbusim efektet e ndryshimeve klimatike.

**d) 1 (një) Ekspert për transportin dhe bujqësinë** - Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime Inxhinieri mekanike, mjedis ose të ngjashme. Të ketë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin industrial. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti për transportin dhe bujqësinë do të trajtojë të gjitha aspektet e ndikimit të transportit dhe bujqësisë në ndryshimet klimatike, si dhe do të ofroj masa konkrete në lidhje me reduktimin e ndikimit të tyre në mjedis.

**e) 1 (një) Ekspert GIS dhe përpunimi i të dhënave** – Me kualifikim Master ose ekuivalent në studime inxhinierike ose të ngjashme. Të ketë përvojë të përgjithshme profesionale në sektorin e GIS. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

-Eksperti GIS do të kontribuojë në ngritjen e një sistemi GIS për përpunimin e të dhënave në nivel lokal, duke përgatitur kështu analizën e të dhënave që do të gjenerohen nga procesi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):**

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

**OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM:** Objektivi i përgjithshëm i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, është

të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të zvogëlojë ndikimet nga to, duke rritur aftësinë zbutëse si dhe të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë, në proceset e menaxhimit të qëndrueshëm dhe planifikimit brenda sektorëve të ndryshëm të qytetit, si dhe projektet strategjike.

**QËLLIMI:** Qëllimi i hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike është përcaktimi dhe marrja e masave prioritare ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike për të shmangur efektet negative, uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e administruar nga Bashkia e Tiranës.

Vlerësimi i situatës aktuale duhet të japë një pamje të qartë për vulnerabilitetet ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë. Shumë elemente të prekshmërisë (vulnerabilitetit) kanë të bëjnë me sektorët e veprimtarive shoqëro-ekonomike (bujqësia, energjetika, shëndetësia, pyjet, turizmi, etj.) dhe shumica e efekteve negative parashikohen se do të rriten në shkallë në të ardhmen. Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë ndjeshëm edhe në sistemet natyrore përfshirë sistemet hidrologjike dhe ekosistemet natyrore, por ato mund të ndikojnë edhe në shtimin e reshjeve dhe fatkeqësive të lidhura me klimën apo edhe pabarazinë dhe vulnerabilitetin social.

Termet e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Ligjin Nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit.

**Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024” (i ndryshuar) ; grupi i punës i ngritur me Urdhër Titullari nr.1268, datë 24.04.2024 për “Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e procedurës me objekt: ”Hartimi i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike”, kanë hartuar kërkesat për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në termat e referencës të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për përlllogaritjen e vlerës së kontratës, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Titullarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit për procedurën ”**Hartimi i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike**”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt ”**Hartimi i Planit të Veprimit për**



**Ndryshimet Klimatike”.**

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit;